REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DEVOLL
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
SEKTORI I KUJDESIT SOCIAL DHE PAK

NJOFTIM

Për hapjen e aplikimeve për programin social të strehimit – subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2026

Bashkia Devoll, në kuadër të programeve sociale të strehimit, konkretisht programit të subvencionimit të qirasë, në përputhje me procedurat administrativo-ligjore të parashikuara në Ligjin nr.22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar me Ligjin nr.48/2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.22/2018 'Për strehimin social'", VKM nr.384, datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas programeve sociale të strehimit dhe afateve e procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM nr.459, datë 03.07.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM nr.362, datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij" si dhe VKM nr.301, datë 15.04.2021 "Për normat e strehimit",

Rregullat e subvencionimit të qirasë

1. Aplikimi i individit/familjes për përfitimin e subvencionimit të qirasë bëhet pranë Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.
   Lista e përfituesve miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore.
   Në rastet kur subvencionimi financohet pjesërisht ose plotësisht nga qeverisja qendrore, lista miratohet nga Bashkia dhe më pas i përcillet ministrisë përgjegjëse për strehimin.
2. Përparësi në përfitimin e subvencionimit të qirasë, sipas sistemit të pikëzimit, kanë këto kategori:
   - Individët me statusin e jetimit
   - Personat me aftësi të kufizuar
   - Invalidët e punës
   - Familjet e policëve të rënë në detyrë
   - Emigrantët e rikthyer
   - Punëtorët emigrantë
   - Azilkërkuesit
   - Familjet e komunitetit rom
   - Familjet e komunitetit egjiptian

- Viktimat e dhunës në familje
- Viktimat e trafikimit
- Prindërit e vetëm me fëmijë në ngarkim
- Individët që i përkasin komunitetit LGBT
- Të mitur 14–18 vjeç dhe të rinj 18–21 vjeç në konflikt me ligjin
- Vajzat nëna, pas daljes nga programet e banesave sociale të specializuara

Kushtet për përfitim

Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr. 22/2018, statusin e përfituesit nga programet sociale të strehimit e gëzojnë individët që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile, të cilët në momentin e aplikimit:

- nuk kanë në pronësi një banesë, ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, ose banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi;
- kanë mbetur të pastrehë si pasojë e:
  - fatkeqësive natyrore;
  - prishjes së objekteve të papërshtatshme për banim;
  - zhvendosjeve për shkak të investimeve publike apo proceseve të legalizimit;
  - zbatimit të akteve administrative ose vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

Nga programet e strehimit social përfitojnë gjithashtu edhe shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në Republikën e Shqipërisë, të pajisur me statusin "punëtor emigrant" dhe/ose "azilkërkues".

Përfitimi nga programi kushtëzohet nga të ardhura të pamjaftueshme ose mungesë të ardhurash, sipas përcaktimeve ligjore.

Gjithashtu, të drejtën për të përfituar nga programet e banesave sociale të specializuara e kanë edhe të miturit nën moshën 18 vjeç, të cilët pas përfundimit të masave alternative apo lirimit mbeten të pastrehë, bazuar në vendim gjyqësor ose akt administrativ.

Për çdo informacion të mëtejshëm, qytetarët mund të drejtohen pranë Zyrës së Kujdesit Social, Bashkia Devoll, ose të aplikojnë online për programin e subvencionimit të qirasë në portalin e-Albania.

Dokumentet duhet të jenë të lëshuara brenda 3 muajve të fundit nga momenti që qytetari bën aplikimin/rifreskimin e dokumentacionit.